

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-181/2014

Prishtinë, 27 korrik 2016

Në çështjen juridike të:

N.J.A.

Zicka 34

36000 Mataruska Banja

Kraljevë

Serbi

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Beshir Islami, Anëtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) nr. KPCC/D/R/223/2013 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numër KPA47648), i datës 27 nëntor 2013, (në tekstin e mëtejme: vendimi i KKPK-së) pas shqyrtimit të mbajtur më 27 korrik 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

Hidhet poshtë si e papranueshme ankesa e N.A. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/223/2013, të datës 27 nëntor 2013, për sa i përket lëndës nr. KPA47648.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 3 shtator 2007, J.N.A., (në tekstin e mëtejme: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon vërtetimin e së drejtës në bashkëpronësi (1/2) ndaj shtëpisë me oborr në sipërfaqe prej 5 Ar, në rrugën Duge Livade, Savska nr. 10, në Ferizaj, ngastra kadastrale nr. 1075/5, e regjistruar në fletën poseduese nr. 3715, zona kadastrale Ferizaj, komuna e Ferizajt (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Paraqitësi i kërkesës ka kërkuar kompensim dëmi pasi që ndërtesat dhe oborri janë shkatërruar. Ai ka pretenduar se e ka humbur pronën e kërkuar për shkak të rrethanave gjatë viteve 1998/1999, ku përmendet data 19 qershor 1999 si data e humbjes, dhe që prona është e zënë nga S.B. .

2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar dokumentet në vijim:
 - Një kopje të letërnjoftimit të paraqitësit të kërkesës me nr. 1907936960021, të lëshuar më 14 qershor 2001;
 - Një kopje të fletës poseduese nr. 3715, të lëshuar nga Zyra e Republikës për Gjeodezi, Qendra për Pronë të Paluajtshme, Kadastrri në Prishtinë, Komuna Kadastrale e Ferizajt, më 22 janar 2002; sipas kësaj flete poseduese, paraqitësi i kërkesës ishte regjistruar si bashkëpronar i pronës së kërkuar dhe prona përbëhej nga një shtëpi dhe objekte, arë të klasës së tretë dhe një oborr në sipërfaqe të përgjithshme prej 10 Ari;
 - Një kopje të planit nr. 995-2/2002-26, të lëshuar nga Komuna Kadastrale e Ferizajt, më 23 janar 2002, që përmban informacione të njëjta si fleta poseduese;
 - Një kopje të Vendimit të Vërtetuar të Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB) nr. HPCC/D/87/2003/C, i datës 29 gusht 2003 për kërkesën DS307009; palët në këtë procedurë ishin paraqitësi i kërkesës dhe S.B. ; KKPB ka urdhëruar që posedimi t'i jepet paraqitësit të kërkesës dhe dëbimin e S.B. ; sipas raportit të referimit të AKP-së – përmes së cilit AKP-ja e ka dërguar kërkesën më vonë për vendosje pranë KKPK – kjo kërkesë ishte lidhur me të njëjtën ngastër, 1075/5 dhe S.B. është dëbuar nga prona rreth vitit 2009.

3. Më 14 korrik 2009, Ekipi për Njoftim i AKP-së ka bërë njoftimin e kërkesës duke vendosur afishe në pronën e kërkuar. Nga njoftimi është gjetur se prona e kërkuar është një shtëpi, një shtëpi e shkatërruar dhe një oborr. Po ashtu është gjetur se prona e kërkuar ishte e zënë nga S.B. . Ai ishte i pranishëm te prona e kërkuar. Ai e ka

nënshkruar deklaratën e palës përgjegjëse në kërkesë duke thënë se ai nuk kërkon asnjë të drejtë ligjore ndaj pronës së kërkuar.

S.B. nuk iu bashkua procedurës pranë AKP/KKPK.

4. Pas verifikimit të fletës poseduese nr. 3715, AKP-ja ia bashkëngjiti dosjes, *ex officio*, Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme UL-72217092-03715, të Zyrës Kadastrale Komunale të Ferizajt, e datës 30 janar 2008. Sipas këtij dokumenti, ngastra nr. 3715-5 me sipërfaqe prej 10 ari është e regjistruar në emër të paraqitësit të kërkesës si pronar i 1/1.
5. Më 28 tetor 2013, AKP-ja e ka kontaktuar paraqitësin e kërkesës. Sipas memos nga ky kontakt 'paraqitësi i kërkesës e ka konfirmuar se ai e ka shitur pronën e kërkuar në vitet 2009/2010, por që nuk i kujtohet emri i blerësit'.
6. Më 27 nëntor 2013, KKPK-ja përmes vendimit të vet KPCC/D/R/223/2013, e ka hedhur poshtë kërkesën me arsyetimin (paragrafët 16, 17 dhe 58) se paraqitësi i kërkesës nuk e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar për shkak të konfliktit gjatë viteve 1998-1999, por si rezultat i shitjes vullnetare pas konfliktit, që tregon se paraqitësi i kërkesës është në gjendje t'i ushtrojë të drejtat e tij të pronës. Prandaj, KKPK-ja konstaton se kërkesa bie jashtë juridiksionit të KKPK-së. Vendimi i KKPK-së në paragrafin 58 i referohet kërkesës për kompensim të dëmit fizik apo humbje të shfrytëzimit të pronës së kërkuar. Lidhur me këtë kërkesë, KKPK-ja jep arsyetimin se sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Paluajtshme Private përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejme: Ligjin nr. 03/L-079), KKPK-ja nuk ka juridiksion ndaj kërkesave të tilla.
7. Vendimi i KKPK-së është pranuar nga paraqitësi i kërkesës më 17 prill 2014.
8. N.J.A. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së më 13 maj 2014. Bashkë me letër-ankesën ai ka dorëzuar edhe:
 - Një kopje të Certifikatës për Njësinë Kadastrale P-72217092-01075-6, të lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale e Ferizajt, më 11 mars 2014; sipas kësaj certifikate ngastra nr. 1075-6 (e hijezuar me të zezë nga Gjykata Supreme) me sipërfaqe prej 620 m², është në bashkëpronësi të palës ankuese.

- Një kopje të certifikatës të zyrtarit për tatim në Ferizaj, e datës 3 nëntor 2014, në emër të palës ankuese; sipas letër-ankesës kjo certifikatë i referohet tatimit të paguar për ngastrën 1075/6;
- Kopje e letërnjoftimeve të paraqitësit të kërkesës dhe palës ankuese.

Pretendimet e palës ankuese

9. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së përmban gabime thelbësore apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale në fuqi. Pala ankuese gjithashtu pretendon se vendimi i përmendur është i bazuar dhe i lëshuar në bazë të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të fakteve.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

10. Gjykata vëren se ankesa është e paraqitur nga pala ankuese dhe jo nga paraqitësi i kërkesës. Letër-ankesa në pjesën ku i referohet paraqitjes së provave, duket që tregon se paraqitësi i kërkesës është babai i palës ankuese, por që pala ankuese nuk përmend asgjë rreth lidhjes familjare dhe as nuk dërgon asnjë provë rreth ndonjë lidhjeje në mes tij dhe paraqitësit të kërkesës. Në përputhje me rrethanat, palë në ankesë nuk është paraqitësi i kërkesës, por pala ankuese.
11. Neni 12.1 i Ligjit nr. 03/L-079 parasheh si në vijim: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, **pala** mund të paraqesë [...] ankesë ndaj vendimit të tillë”*.
12. Pala ankuese nuk ishte palë në kërkesë në procedurë pranë KKPK-së. Prandaj, ankesa e Ankuesit duhet të shqyrtohet në kuptim të nenit 186 paragrafi 3 dhe neni 196 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LCP).
13. Pala ankuese në ankesën e tij nuk e përmend se ai është duke e përfaqësuar një person tjetër, d.m.th paraqitësin e kërkesës, dhe as nuk paraqet ndonjë bazë ligjore për përfaqësim të tillë. Pala ankuese në ankesën e tij nuk paraqet madje as ndonjë dokument i cili mund të dëshmojë marrëdhënien në mes tij dhe paraqitësit të kërkesës. Gjykata Supreme në vazhdim konsideron në këtë drejtim se Certifikata e Kadastrit që pala

ankuese e paraqet në ankesën e tij nuk i referohet pronës së kërkuar me ngastrën kadastrale numër 1075/5, por një ngastre tjetër me numër 1075/6. Pra, edhe ky dokument – që është i dorëzuar pa asnjë shpjegim – nuk mund ta vërtetojë ndonjë pozicion legjitim të palës ankuese në këtë ankesë.

14. Si rrjedhojë, gjykata nuk gjen asnjë arsye se pse pala ankuese duhet të ketë të drejtë të paraqes ankesë, si palë për interesat e veta dhe as si përfaqësues i paraqitësit të kërkesës.
15. Prandaj, ankesa e palës ankuese është e papranueshme në baza procedurale (neni 13.3 (b) i Ligjit nr. 03/L-079).
16. Në bazë të mësipërmes dhe në pajtim me nenin 13.3 nën c, të Ligjit nr. 03/L-079, gjykata vendosi si në dispozitiv.

Këshillë juridike

Sipas nenit 13.6 të Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Beshir Islami, Gjyqtar

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it